

# INFORMACION PER FAQEN E INTERNETIT TE BKT-se BAZUAR MBI PARIMET E UDHËHEQJES SE KORPORATES

Përditësuar më 30 shtator 2020

## 1. POLITIKA E SHPËRNDARJES SË FITIMIT

Mekanizmi i vendimmarrjes per shpërndarjen e fitimit tek Banka Kombëtare Tregtare ("BKT" ose "Banka") përbëhet nga rekomandimi i bere nga Keshilli Drejtues dhe miratimi i marrë nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve në BKT mbahet të paktën një herë në vit, duke synuar që të miratojë pasqyrat financiare të Bankës dhe të vendosë për shpërndarjen e fitimit te vitit te fundit financiar të mbyllur.

Bazuar në vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, të gjitha fitimet e realizuara nga BKT gjatë viteve financiare 2000-2015 janë kapitalizuar dhe janë përdorur nga Banka për të mbeshtetur zmadhimin e vazhdueshëm të bilancit dhe për të rritur fitimin.

Më 30 mars 2017 Banka realizoi shpërndarjen e parë të dividendit tek Aksioneri i saj.

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të BKT është zhvilluar dy herë përgjatë vitit 2019, më 1 prill dhe 29 korrik 2020.

Mbledhja e Përgjithshme datë 1 prill 2020, miratoi rezolutën Nr. 2 si më poshtë:

"Miratohen pasqyrat financiare statutore dhe SNRF të audituara nga "Grant Thornton" sh.p.k., për vitin financiar mbyllur më 31 dhjetor 2019".

Që sipas rekomandimit të Këshillit Drejtues, fitimi neto i vitit 2019; 6,634,125,622 Lekë të përdoret si më poshtë:

- a) Një pjesë e fitimit neto: 331,706,281 Lekë do të përdoret si rezervë ligjore bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- b) Një pjesë e fitimit neto: 1,326,825,124 Lekë do të përdoret për krijimin e rezervës së përgjithshme bazuar në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë Nr.69, datë 18.12.2014 "Pë kapitalin rregullator të Bankës";
- c) Vlera e akumuluar nga fitimi i pashpërndarë për vitin 2018 në shumën 1,181,869,048 Lekë si dhe një pjesë e fitimit neto të vitit 2019, në shumën në Lekë 3,508,530,952, në total 4,690,400,000 Lekë ekuivalent në USD 40,000,000, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e sotme, USD 1.00 = Lekë 117.26, do të përdoret për t'u shpërndarë si dividend tek Çalik Finansal Hizmetler A.S., si aksioner i vetëm i BKT. Kjo shumë do të paguhet në datën 04 Maj 2020.
- d) Pjesa e mbetur e fitimit neto: 1,467,063,265 Lekë do të mbahet si fitim i pashpërndarë.

Në rezolutën nr. 7 "Grant Thornton" sh.p.k. emërohet si auditor i jashtëm i Bankës (Ekspert Kontabël i Autorizuar) për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2020.